



BASHKIA DEVOLL

RELACION

Program I Buxhetit Afatmesem 2019-2021

Bashkia DEVOLL

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-buxheti i paraqitur përpara jush për miratim, është parashikimi i dy komponentëve kryesore përbërës së tij ,

- Të ardhurat vendore
- Shpenzimet për vitet 2019-2021 nëpërmjet të cilave do të bëhet i mundur realizimi i shërbimit ndaj qytetit dhe qytetareve, perkrahja e shtresave ne nevoje si dhe investimeve kapitale per gjithë territorin e Bashkinse.

HYRJE

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar) dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor. Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së PBA-së, kështu buxheti vjetor është viti i parë i PBA-së. Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë Devoll është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, të cilat lidhen me funksionet respektive të pushtetit vendor të përcaktuara në kuadrin ligjor.

Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga Njësitë Shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësorë të zhvillimit dhe identifikimit të prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2019-2021 janë kërkesat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve publike me qytetarët e të 4 njësive administrative dhe qytetit Bilisht dhe programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për vitet 2015-2019.

Ky projekt-buxhet bazohet në misionin tonë për të siguruar një qeverisje të efektshme,efikase dhe në një nivel sa më të afër qytetarëve.Realizimi I shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative. Respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të saj.

➤ **Bashkia Devoll ka aplikuar por nuk ka një Plan të Përgjithshëm Vendor**

Programi buxhetor afatmesem bazohet tek politikat e programit te kryetarit të bashkisë te cilat janë

1. Zhvillimin parësor të bujqësisë

Krijimi I hapësirave dhe mundësive që do të ndihmojne sektorin e produkteve bujqësore që kërkohen nga tregjet kombetare,rajonale dhe më gjërë.

-Zhvillimin me përparësi të frutikulturës,kultivimin e arrorëve, farorëve dhe bimëve medicinal etj.

-Rehabilitimin e sistemeve ujitës e kullues të tokës, me synimin për të ujitur 100% të sipërfaqes.

-Zhvillimin e blegtorisë.

2. Ne infrastrukturë

-Hartimit e masterplanit urbanistik afatgjatë për të gjithë zonën e Devollit,në të cilin do të integrohen 45 qëndrat e banuara.

-Ndërtim dhe rehabilitim shkollash,ambientesh sportive,ndërtim qëndrash kulturore dhe shëndetësore në cdo fshat.Ndërtim ambientesh clodhese dhe rekreative për të gjithë qytetarët,moshën e tretë, fëmijet dhe të rinjtë

-Rehabilitimin e qendrës së qytetit,për ti dhënë pamjen e një qendre urbane bashkëkohore, rehabilitimin e rrugëve kryesore dhe të lagjeve, shënjimin e tyre me emrat përkatës ,sistemin e parkimit të automjeteve, shtimin e sipërfaqeve të gjelbra si dhe finalizimin e projektit të kanalizimit të ujrave të zeza.

-Ndërtimi I një cerdhe të re,ndërtimi I një pallati culture me bibliotekë.

3. Per kulturën dhe sportin.

-Rritja e gamës së aktiviteteve kulturore dhe sportive me synim ngritjen e një trupe teatrore,ngritjen e asamblit të këngës dhe valles devollice sipas grup-moshave

4. Turizmi

-Hartimi I guidës turistike të Devollit, nxitja e projekteve konkrete me uljen e taksave e tatimeve si dhe lehtësimi I lejeve të ndërtimeve për turizmin malor dhe atë liqeno-lumor, turizmin historik dhe kulturor.

5. Për pyjet dhe kullotat.

-Marrja e masave konkrete për shtimin, mbarështrimin dhe mbrojtjen e pyjeve komunale shfrytëzimin me kriter të tyre, do të ndërhyjmë me masa efektive për rehabilitimin dhe shfrytëzimin racional e me efektivitet te kullotave.

6. Për punësim

-Hapje dhe krijim të vendeve të reja të punës nëpërmjet rritjes së investimeve, stimulimit të biznesit, punëve publike dhe shërbimeve publike.

7. Për biznesin dhe mrrë-dhëniet me biznesin

-Do të ndjek politika nxitëse dhe lehtësuese përmes ujitjes dhe barrës fiskale,përsheptimit të dhënies së lejeve të ndërtimit, përpilimit të programeve afatgjata në ndihme të biznesit.

8. Për shtresat në nevojë,njerzit me aftësi të kufizuar, emigrantët, romët

-Dhenia e ndihmës ekonomike dhe financiare për familjet në nevojë pa asnje lloj diferencimi politik e social.Duke u bazuar në politika afatgjata,mundësi punësimi të romëve dhe shtresave në nevoje,integrimin e tyre në shoqëri, shkollimin dhe strehimin e tyre

KAPITULLI I PROCESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë Devoll, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritarë të identifikuar në Programin e Bashkisë së Devollit dhe në dokumentat e tjerë strategjikë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Rol domethënës në hartimin e kësaj PBA-je kanë luajtur edhe qytetarët e Bashkisë Devoll, të cilët në kuadër të takimeve “Buxheti me pjesëmarrje” kanë shprehur prioritetet e tyre për shpenzimet publike. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm:

a. Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e efijencës së përdorimit të fondeve buxhetore, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

b. Sigurimi i një shpërndarjeje dhe përdorimi efektiv dhe efijent i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:

- Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
- Forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- Krijimi i një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioritetëve politike, të shprehura në programin politik të Bashkisë Devoll, dhe prioritetëve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion;
- Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare);
- Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve;
- Inkurajimi i efektivitetit, efijencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve;
- Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Kryetarit të Bashkisë Devoll për mandatin 2015-2019 me nevojat e qytetarëve duke i përkthyer në politika vendore dhe konkretizuar në plane shpenzimesh.

Programi Buxhetor Afatmesëm 2019-2021

Ky dokument synon të informojë Këshillin Bashkiak Devoll dhe publikun e gjerë lidhur me planet afatmesme të shpenzimeve të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të programit të Kryetarit të Bashkisë Devoll.

Dokumenti synon t'i japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh në periudhë afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program iu shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritare në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikat fiskale dhe financiare të Bashkisë Devoll.

Gjithashtu, parashikimi i të ardhurave e shpenzimeve dhe përcaktimi i fondeve afatmesme në dispozicion për investime, krijojnë mundësinë për vlerësimin e aftësive kredimarrëse të Bashkisë Devoll, dhe lejon në këtë mënyrë përdorimin e një instrumenti alternativ për rritjen e investimeve kapitale, të financuar nga burime të jashtme dhe të brendshme, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në dobi të komunitetit.

Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje

qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërthurur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet:

- a. Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, interesa),
- b. Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë Devoll.
- b. Institucionet e varësisë

Konsultimi i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Bashkia Devoll i jep përparësi thelbësore përfshirjes qytetare si hallkë e rëndësishme në vendimmarrje, për sa i përket projekteve, investimeve dhe shërbimeve që ky institucion garanton ndaj qytetarëve të kryeqytetit. Vendimmarrjen me pjesëmarrje Bashkia e zbaton edhe në bazë të parimeve themelore të funksionimit të një qeverisje demokratike dhe të shtetit të së drejtës, parime të tilla si: parimi i transparencës, gjithëpërfshirës, zbatimit të ligjshmërisë, subsidiaritetit etj.

.ëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin me pjesëmarrje u realizua edhe këtë vit në 4 njësitë administrative, ku u paraqitën projektet e nisura tanimë, si edhe ato risi në punë dhe investime publike, të cilat parashikohen të financohen dhe realizohen gjatë viteve të ardhshëm.

Gjatë këtyre dëgjësive të zhvilluara, u zhvillua gjithashtu një sondazh mbi projektbuxhetin për vitin 2019. Qëllimi i këtij sondazhi ishte të evidentonte mendimin qytetar rreth nevojave dhe prioriteteve që ka secila zonë në veçanti dhe vlerësimin e qytetarëve pjesëmarrës në dëgjësat publike për cilësinë dhe informacionin e prezantimit të projektbuxhetit të secilën njësi administrative

Nevojat dhe sugjerimet e ardhura nga qytetarët variojnë në funksion të zonave të banimit dhe problematikave të ndryshme që këto paraqesin, sipas shembujve të mëposhtëm:

- **Në Njësinë Administrative Miras** nevojat më të shumta shkojnë për infrastrukturë rrugore dhe përmirësim të shërbimit të transportit public, përmirësimi I rrjetit të kanaleve ujitëse dhe ndricimi rrugor.

- **Në Njësinë Administrative Hociht** kërkesat më të shumta janë për ndricimin e disa zonave dhe punësimin e të rinjve si dhe rehabilitimin e kanaleve kullues dhe vaditës.

- **Në Njësinë Administrative Proger** kërkesat më të shumta infrastrukturë rrugore dhe përmirësim të shërbimit të transportit public, përmirësimi I rrjetit të kanaleve ujitëse dhe ndricimi rrugor, rehabilitimi I ujrave të zeza dhe pastrami.

- **Në Njësinë Administrative Qender** kërkesat më të shumta infrastrukturë rrugore përmirësimi I rrjetit të kanaleve ujitëse dhe ndricimi rrugor, rehabilitimi I ujrave të zeza dhe pastrami si dhe punësimi.

- **Në qytetin Bilisht** kërkesat më të shumta infrastrukturë rrugore dhe përmirësim të shërbimit të transportit publik,

Kërkesat më të shumta janë kryesisht në infrastrukturën rrugore dhe rehabilitimin e kanaleve kullues për zonat rurale. Ky është edhe orientimi I shpenzimeve buxhetore për vitet në vazhdim.

KAPITULLI II

PRIORITETET AFATMESME 2019-2021

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2017-2019 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Bashkisë Devoll dhe në Programin e Kryetarit të Bashkisë për mandatin 2015-2019.

Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm:

Objektiviti themelor i PBA-së do të përmirësimi I procesit të planifikimit, hartimit dhe zbatimit të buxhetit si dhe kthimi I Bashkisë Devoll në një zonë më të mirë për të jetuar. Ky objektivi do të realizohet përmes mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes, garantimit të cilësisë në tregjet publike dhe rritjes së sigurisë në rrugë e në objektet shkollorë; përmirësimi të kushteve në çerdhe, kopshte e shkolla dhe ofrimit të shërbimeve sociale cilësore; meremetimit të infrastrukturës rrugore, përmirësimi të transportit publik, fuqizimit të rinisë dhe shtresave të tjera, rigjallërimit të jetës kulturore dhe masivizimit të sporteve; rritjes së punësimit dhe zhvillimit të ekonomisë rurale.

Shtyllat kryesore në të cilat është mbështetur hartimi i buxhetit afatmesëm do të jenë pikërisht këto synime:

- Zhvillimi ekonomik i qytetit dhe nxitja e punësimit e sipërmarrjes;
- Ofrimi i shërbimeve cilësore;
- Përmirësimi i infrastrukturës arsimore;
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit;
- Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes;
- Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive;
- Ndërtimi i veprave publike.

Projekte Strategjike:

Në PBA-në 2018-2020 ishin përfshirë një sërë projektesh strategjike, të cilat ose janë shumë pranë përfundimit ose janë realizuar tashmë.

- **Projekti i Rikualifikimit urban të qendrës së qytetit Bilisht.**
- **Projekti për ndërtimin e brendshëm fshati Verlen.**
- **Projekti për bashkëfinancimin e ujësjellësit rajonal në Njes. Adm. Miras.**

➤ **Studim Projektet të cilat janë parashikuar në projekt-buxhet 2019-2021**

Studim proje.obj."Rruga Perparimaj-Grapsh"
Studim proje.obj."Rruga Zicisht-Gjyres"
Stud.proje.obj." Rikualifikim urban I fshatit Qyteze"
Stud.proje.obj." Rikualifikim urban I fshatit Sinice"
Stud.proje.obj." Rikualifikim urban I fshatit Arze"
Stud.proje.obj." Rikualifikim urban I fshatit Grapsh"
Stud.proje.obj." Rikualifikim urban I fshatit Gjyres"

➤ **Ndërhyrjet në infrastrukturën e qytetit:**

1. Rrugët dhe Transporti Publik

Investimet brenda këtij programi do të përmirësojnë edhe më shumë cilësinë e infrastrukturës rrugore, duke aplikuar standartet më të larta në gjithë territorin e Bashkisë Përveç investimeve në rrugica e blloqe banimi, do të riparohen edhe rruge ne njesitë administrative. Programi Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 Në kuadër të reformës administrative dhe zgjerimit të territorit të Bashkisë Devoll, vitin e ardhshëm do të rikonceptohen dhe ristrukturohen linjat e transportit nga fshatrat, deri në ndërtimin e terminaleve të udhëtarëve.

2. Shërbimet Publike

Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e cilësisë së jetesës nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në blloqet e banimit ne qytet dhe përmirësimin e rrugëve të zonave të banuara. Një nga objektivat më të rëndësishëm do të jetë garantimi i pastërtisë në rrugë dhe në hapësirat publike. Gjatë vitit të ardhshëm do të rikonceptohen dhe strukturohen zonat dhe shërbimet e pastrimit në gjithë territorin e Bashkisë Ndrichi do të jetë një nga përparësitë kryesore gjatë vitit të ardhshëm dhe do të synohet rikualifikimi i rrjetit ekzistues duke riparuar ndriçuesit e dëmtuar dhe duke zëvendësuar ata që mungojnë. Gjatë viteve në vazhdim, përparësi do t'i jepet gjelbërimit dhe hapësirave çlodhëse. Kësisoj, është planifikuar mbjellja e pemëve dhe bimësisë dekorative, si edhe pajisja me kosha mbeturinash .Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe krijimit të këndeve sportive të reja apo rehabilitimit të atyre ekzistuese.

. 3. Arsimi Parauniversitar

Investimet brenda këtij programi, të cilat synojnë përmirësimin e infrastrukturës arsimore si dhe ambjenteve ndihmëse e rekreative në të gjitha objektet arsimore,

1. Strehimi

Për të përmirësuar dhe rritur cilësinë e kushteve të jetesës për familjet në nevojë për strehim të cilët nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofërtën e tregut të lirë të

banesave ose atë të kredive hipotekore, Bashkia Devoll synon zbatimin e programit të banesave për dhënien e bonusit të strehimit për familjet e pastreha. Duke qenë se aplikimet për këtë program kanë vazhduar, Bashkia Devoll do të marrë përsipër të vazhdojë këtë program duke u bazuar në burimet e veta financiare.

KAPITULLI III KUADRI FISKAL DHE EKONOMIK 2017-2019

Politikat tatimore dhe parashikimi i të ardhurave tatimore për periudhën afatmesme Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Devoll është mbështetur kryesisht në llogaritjet e kapacitetit të taksave e tarifave, informacioni i përfituar nga programi i taksave vendore, në ecurinë e realizimit të tyre në vite si dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim, duke u mbështetur në aktet ligjore për to.

Parashikimi i të ardhurave për këtë periudhë afatmesme reflekton dhe ndryshimet në paketën fiskale si dhe parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;

Në këtë parashikim janë marrë në konsideratë:

- Rritja të ardhurave nëpërmjet rritjes së bazës së taksapaguesve dhe luftës kundër evazionit fiskal (evidentimi i subjekteve mospaguese dhe atyre të reja);
- Lehtësimi i procedurave në marrëdhënie me subjektet;
- Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe analiza një për një e çdo takse &tarife, për faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve;

KAPITULLI IV PARASHIKIMET BUXHETORE AFATMESME 2019-2021

Në vijim të përmbushjes së objektivit për rritjen e standardeve dhe cilësisë së shërbimeve, nëpërmjet rritjes së efikasitetit në menaxhimin e shpenzimeve, buxheti është hartuar bazuar në:

– Zhvillimin e sistemit të planifikimit afatmesëm, në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, si një mjet për integrimin sa më mirë në procesin buxhetor, të objektivave politike e strategjike të Bashkisë Devoll;

- Aplikimin e sistemit të buxhetimit me pjesëmarrje, bazuar në konsultimet paraprake me banorët e çdo njësie administrative;
- Forcimin e administratës tatimore dhe rritjen e efikasitetit për realizimin e të ardhurave në kufijtë e kapacitetit;
- Zhvillimin e burimeve alternative të financimit.

Në terma të përgjithshëm programi financiar i Bashkisë Devoll për periudhën 2019-2021 paraqet:

- Parashikimin e të Ardhurave: Parashikon rritjen e nivelit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore duke forcuar kapacitetet administruese dhe duke rritur numrin e taksapaguesve;
- Parashikimin e Shpenzimeve: Alokimin/shpërndarjen e të ardhurave për vitet në vazhdim për:

Shpenzime kapitale sipas programeve të zhvillimit të bashkisë,

- o Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes për përmbushjen e funksioneve;
- o Shpenzime personeli;
- Buxheti ka në fokus rritjen e cilësisë së shërbimeve në sektorët prioritarë, shërbime publike, arsim dhe infrastrukturë rrugore;
- Zbatimin e politikave kombëtare për përcaktimin e nivelit të pagave;
- Raporti midis shpenzimeve korente dhe atyre kapitale.
- Raporti i burimeve të financimit paraqitet:

IV.1 TË ARDHURAT E BASHKISË DEVOLL PËR PERIUDHËN 2019-2021

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë Devoll, përbëhen nga:


I. Të ardhurat e veta:

- a) Të ardhurat nga taksat
- b) Të ardhurat nga tarifatat


II. Transferta e pakushtëzuar.


III. Transferta e kushtëzuar;

Në vija të përgjithshme parashikimi i të ardhurave për vitet 2019-2021, paraqitet me këto vlera:



Te ardhurat e tjera përfshijnë të ardhura të trashëguara nga vitet e kaluara për shlyerjen e kontratave të trashëguara, detyrime dhe shpenzime të palikuiduara.





I. TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

➤ TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

1. Takse mbi Ndertesat

2. Takse mbi Token Bujqesore

3. Taksa mbi Truallin

➤ TAKSA E FJETJES NE HOTEL

➤ **TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTES SE PRONESISE MBI PASURITE E**

PALUAJTSHME

➤ **TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA**

➤ **TAKSA E REGJISTRIMIT TE PERVITSHEM TE MJETEVE**

➤ **TAKSA PER ZENIEN E HAPESIRAVE PUBLIKE**

➤ **TAKSA E TABELES DHE REKLAMES**

I. TATIM I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

Cdo subjekt,i cili kryen nje biznes,me ane te te cilit realizohet gjate vitit fiskal qarkullim me i vogel ose i barabarte me 8.000.000 (*tetemillion*) leke i nenshtrohet detyrimit te pageses se tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel.

Baza e takses/tatimit; Kestet e parapagimit te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin,per vitin vijues,per tatim paguesit me qarkullim vjetor nga 5.000.000-8.000.000 milion leke.llogariten ne baze te te dhenave te deklarates tatimore te n je viti me pare.

Niveli i tatimit:Nivelet e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel paraqiten si ne tabelen e meposhteme;

Taksa e Tatimit te Thjeshtuar mbi Fitimin per Biznesin e Vogel


Nr	Qarkullimi vjetor i biznesit	Niveli i Takses	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
	Me qarkullimvjetor nga 0 – 5.000.000lekë	0	0
	Me qarkullim vjetor nga 5.000.001 – 8.000.000 lekë	5% e fitimit	5% e fitimit

Menyra e pageses: Tatim paguesi parapaguan ne llogarine e organeve tatimore keestet tremujore te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin te biznesit te vogel Brenda dates 20 prill per tremujorin e pare, brenda dates 20 korik per tremujorin e dyte, brenda dates 20 tetor per tremujorin e trete dhe brenda dates 20 dhjetor per tremujorin e kater.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses/tatimit: Drejtoria Rajonale Tatimore ne rolin e agentit tatimor eshte e ngarkuar per mbledhjen e kesaj takse dhe kalimin e saj per llogari te buxhetit te qeverisjes vendore te te ardhurave nga tatimi I thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel.Per kete sherbim D.R.T Korce perfiton 1 % te te ardhurave nga ky ze.

Te ardhurat e parashikuara nga kjo takse: Duke pare dhe analizuar tabelen mesiper shohim qe kemi parashikuar te ardhura nga Nj.A Bilisht me teper,kjo pasi bizneset me te medha me nivel

xhiro nga 5.000.000-8.000.000 lek dhe me potencial te madh ndodhen ne Qytetin e Bilishtit. Per vitin 2018 kemi parashikuar 1,000,000 lek te ardhura nga kjo takse pasi dhe numri i bizneseve te vogla me qarkullim vjetor nga 5-8 milion jane te pakta. Shumica e bizneseve te vogla qe operojne ne teritorin e Bashkise Devoll kane nje qarkullim me te vogel se 5.000.000 lek dhe si rezultat nuk do ti nenshtrohen tatimit te thjeshtuar te fitimit. Kjo takse per shkak te ndryshimit te ligjit pati nje ndikim te madh ne te ardhurat e buxhetit te Bashkise pasi kjo takse zinte nje vend te rendesishem ne te ardhurat tatimore te Bashkise.



II. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

Taksat mbi pasurine e paluajtshme i nenshtrohen te gjitha personat fizike ose juridike, vendas ose te huaj, pronare apo perdorues te pasurive te paluajtshme ne teritorin e Republikes se Shqiperise, pavaresish nga niveli i shfrytzezimit te ketyre pasurive. Bejne perjashtim rastet kur ne ligj parashikohet ndryshe. Detyrimi per taksen mbi pasurine e paluajtshme e ka sipas rastit pronari ose bashkepunatori sipas pjeses qe zoteron apo perdoruesi i pasurise se paluajtshe per pasurite qe nuk jane te pajisura me dokumente pronesie.

Ne taksat mbi pasurine e paluajtshme perfshihen:

- 1. Taksa mbi ndertesat**
- 2. Taksa mbi token bujqesore**
- 3. Taksa mbi truallin**

Ne rast te mungeses se dokumentacionit te pronesise (ndertese, token bujqesore, truall) perdoruesi i pasurise ben nje vete deklarim te siperfaqes prane bashkise. Bashkia nepermjet komisionit te ngritur mund te vleresoje siperfaqen e taksueshme.

1. Takse mbi Ndertestat

Baza e taksat: Eshte siperfaqja e ndertimit ne meter katror e nderteses ose pjeses se saj mbi dhe nen nivelin e tokes dhe per cdo kat. Dokumentat qe vertetojne pronesine jane: Certifikata e Pronesise, Vendimi I Komisionit te Kthimit te Pronave, Vendimi i Privatizimit

Kategorite e takses mbi ndertesat: Nivelete dhe kategorite e takses mbi ndertesat paraqiten si meposhte ku i kemi te ndara ne tre kategori, ne ndertesa per familjet, ndertesa per biznes te vogel dhe ndertesa per biznese te medha ku cdo kategori ka dhe nen kategorite e saj.

- Ne kategorine **ndertesa per Familjet** perfshihen:

-Te gjitha hapesirat qe perdoren nga qytetaret vetem per qellime banimi.

-Ndertesa ne pronesi te shoqerive te ndertimit te pashitura por te hipotekuara si ndertesa banimi

-Ndertestat do te taksohen dhe sipas vitit te ndertimit (para dhe pas vitit 1993)

- Ne kategorine **ndertesa per Bizneset e Vogla** perfshihen:

-Ndertesa per Tregeti dhe Sherbime ku ne te cilat perfshihen te gjitha ndertesat per tregeti ushqimore, industrial, fast-fude, restorante, hotelet, pika

karburanti, magazine, zyra, farmaci, komplekse sportive dhe njesi tregetare dhe sherbimi te cdo lloji etj. Te ngjashme me to, gjithashtu dhe ndertesat e shoqerive te ndertimit te cilat jane te pashitura port e hipotekuara si ndertesa biznesi.

-Ndertesa te Tjera do te kuptojme te gjitha ndertesat e tjera te cilat nuk perfshihen ne kategorine e mesiperme

-Ndertesa per Veprimtari Prodhuese do te kuptojme te gjitha ndertesat ne te cilat ushtrohet aktiviteti prodhues si perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letre, plastmasi, tulla, tjegulla, fura gelqereje, prodhime ushqimore, fure buke, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe perpunim produktesh blektorale dhe bujqesore.

- Ne kategorine **ndertesa per Bizneset e Medha** perfshihen tre nenkategorite e ndertesave per biznes te vogel por ne ndryshim ne kete kategori perfshihen te gjitha ndertesat ku ushtrohet aktivitet tregetar i klasifikuar si biznes i madh.

Taksa mbi Ndertestat

Nr.	Kategorite e Ndertesave FAMILJET	Niveli i Takses	
		Nj. Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Ndertesa para vitit 1993 rritet	5 lek/m ²	2.5 lek/m ²
2.	Ndertesa gjate dhe pas vitit 1993	6 lek/m ²	3 lek/m ²
	BIZNES I VOGEL	Nj. Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Ndertesa per Tregeti dhe Sherbime	200 lek/m ²	100 lek/m ²
2.	Ndertesa te Tjera	40 lek/m ²	20 lek/m ²
3.	Ndertesa per veprimtari Prodhuese	100	50

		lek/m2	lek/m2
	BIZNES I MADH	Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Ndertesë për Tregëti dhe Shërbime	200 lek/m2	100 lek/m2
2.	Ndertesë të Tjera	40 lek/m2	20 lek/m2
3.	Ndertesë për veprimtari Prodhuese	100 lek/m2	50 lek/m2

Parashikimi për vitet në vazhdim:

Taksa e ndertesës	2018	2019	2020	2021
Vlera/në mijë lek	8860.70	8950.00	9039.3	9128.6

Detyrimi për pagesë të takses mbi ndertesën është vjetor. Sektori i të ardhurave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së takses sipas tabelës më sipër.

Struktura përgjegjëse për vjeljen e takses: Detyrimi për familjet e njësive administrative Bilisht shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga SH.A Ujësjetësi Bilisht në cilësinë e agjentit tatimor. Për shërbimin agjenti përfiton 2 % të shumës së arketuar. Ndërsa njësitet administrative të tjera taksat familjare do të mbledhen nga punonjësi e taksave në njësine përkatëse duke shkuar në çdo familje.

Deri në paraqitjen e dokumentacionit të pronësive ose vetedeklarimit të sipërfaqes së ndertesës detyrimi vjetor i takses së ndertesës për familjet llogaritet për një sipërfaqe mesatare prej 100 m². Detyrimi për biznesin llogaritet nga Sektori i të Ardhurave dhe pas marrjes së faturës biznesi shlyhet pranë bangave të nivelit të dytë brenda datës 20 prill të vitit fiskal, n.q.s celen pas datës 20 prill, shlyerja e detyrimit për taksen e ndertesës bëhet deri në 30 ditë nga data e regjistrimit në Q.K.R.

Duke parë dhe analizuar të ardhurat e parashikuara nga kjo takse vëmë re se pjesën më të madhe të kësaj takse e ze taksa e ndertesës për familjet, ku është bërë një përlogaritje në bazë të numrit të familjeve të dhëna nga zyra e gjendjes civile dhe numrit të familjeve faktike që jetojnë në territorin e Bashkisë Devoll duke marrë një mesatare të të dyjave. Gjithashtu një peshe specifike në buxhet ka dhe taksa e ndertesës për bizneset e vogla dhe të mëdha në një vlerë prej 3.656.000 lek ose 47% të takses totale të ndertesës, dhe ky parashikim i të ardhurave është bërë mbi bazën faktike të metrave katror të bizneseve që kanë deklaruar dhe paraqitur dokumenta, matjeve nga një komision i ngritur nga Bashkia i ambienteve tregëtare duke marrë një mesatare të dy treguesve.

2.Taksa mbi Token Bujqesore

Toke Bujqesore eshte toka e percaktuar si e tille ne regjistrin e zyrate te regjistrimit te pasurive.

Baza e takses: Eshte siperfaqja e tokes bujqesore ne hektar ne pronesi apo ne perdorim te taksapaguesit. Siperfaqja e tokes percaktohet mbi bazen e dokumentave te pronesise, formularit nr.6, aktit te pronesise, certificates se regjistrimit te toke.

Niveli i takses mbi token bujqesore paraqitet si meposhte:

Taksa mbi Token Bujqesore

Nr.	KATEGORITE E TOKES	Niveli I Takses	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Kategoria e I	3640 lek/ha	3640 lek/ha
2.	Kategoria e II	2730lek/ha	2730 lek/ha
3.	Kategoria e III	1820 lek/ha	1820 lek/ha
4.	Kategoria e IV	1755 lek/ha	1755 lek/ha
5.	Kategoria e V	1625 lek/ha	1625 lek/ha
6.	Kategoria e VI	1560 lek/ha	1560 lek/ha
7.	Kategoria e VII-X	1430 lek/ha	1430 lek/ha

Te ardhura te parashikuara nga taksa mbi token bujqesore:

Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera/ne mije lek	20787.79	20900	21012.21	21124.41

Detyrimi per taksen bujqesore llogaritet nga sektori i te ardhurave dhe per familjaret e njesise administrative Bilisht shlyhet ne baze mujore si pjese perberese e fatures se sherbimit te furnizimit me uje nga SH.A Ujesjellesi Bilisht ne cilesine e agjentit tatimor. Per sherbimin agjenti perfiton 2% te shumes se arketuar.Ndersa njesite administrative te tjera taksat familjare do te mblidhen nga punonjesi e taksave ne njesine perkatese duke shkuar ne cdo familje.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses: Per te gjitha kategorite eshte sektori i te ardhurave ne Bashkine Devoll.Ngarkohet sektori i AMT-ve prane Bashkise Devoll per percaktimin e siperfaqes ne pronesi sipas personave duke pasqyruar dhe ndryshimet e herepasheresshme dhe ia percjell kete informacion Sektorit te te Ardhurave per llogaritjen e detyrimit.

3.Taksa mbi Truallin

Truall eshte nje siperfaqe toke jo bujqesore qe ndodhet brenda vijes kufizuese te ndertimit e percaktuar nepermjet dokumenteve ligjore te planifikimit e miratuar per te ndertuar mbi te.

Baza e takses: Eshte siperfaqja e truallit ne meter katror ne pronesi apo perdorim te taksapaguesit.


Niveli i takses mbi truallin paraqitet ne tabelen meposhte.

Taksa mbi Truallin

Nr.	KATEGORITE E TOKES	Niveli i Takses	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Taksa e truallit per banim per familjet	0.28 lek/m ²	0.28 lek/m ²
2.	Taksa e truallit per qellime biznesi	15 lek/m ²	15 lek/m ²

Te ardhura te parashikuara nga taksa mbi truallin

Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera/ne mije lek	1512.6	1530	1547.4	1564.8



Detyrimi per taksen mbi truallin eshte vjetor.Sektori i te ardhurave kryen llogaritjen ne baze te siperfaqes dhe vleres se takses sipas tabelës dhe klasifikimit mesiper.Informationi mbi siperfaqet e truallit mbi te cilen eshte bere parashikimi i te ardhurave eshte mare nga sektori i planifikimit dhe zhvillimit te teritorit.

Detyrimi per taksen e truallit per familjaret e njesise administrative Bilisht shlyhet ne baze mujore si pjese perberese e fatures se sherbimit te furnizimit me uje nga SH.A Ujesjellesi Bilisht ne cilesine e agjentit tatimor.Per sherbimin agjenti perfiton 2 % te shumes se arketuar.Ndersa njesite administrative te tjera taksat familjare do te mblidhen nga punonjesi e taksave ne njesine perkatese duke shkuar ne cdo familje.

Deri ne paraqitjen e dokumentacionit te pronesisë ose vetedeklarimit te siperfaqes se truallit detyrimi vjetor referees i takses se truallit per familjet llogaritet per nje siperfaqe mesatare prej 100 m2.Detyrimi per biznesin llogaritet nga Sektori i te Ardhurave dhe shlyhet prane cdo bange te nivelit te dyte sipas afateve te tjera te taksave vendore te biznesit.

Deri ne paraqitjen e dokumentacionit te pronesise ose vetdeklarimit te siperfaqes se truallit detyrimi vjetor referees i siperfaqes se truallit per bizneset llogaritet ne baze te siperfaqes se ndertesese se aktivitetit.

III. TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Hotelet ne zonen tone jane te pakte ne numer. Zona jone nuk eshte nje zone me tipare te theksuara turistike gje e cila do te rite numrin dhe cilesine e sherbimit ne hotele.

Baza e takses se fjetjes ne hotel eshte numri i neteve te qendruara ne hotel per person dhe niveli i takses se fjetjes ne hotel dhe parashikimi i te ardhurave nga kjo takes paraqitet ne tabelen meposhte:

Taksa e fjetjes ne hotel

Nr.	Emertimi i Takses	Niveli i Takses	
		<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>
	Taksa e fjetjes ne hotel	35 lek/nate	35 lek/nate

Te ardhura te parashikuara nga taksa e fjetjes ne hotel:

Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera /ne mije lek	57	58	59	60

Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim i nivelit te takses se vendosur nga Bashkia, per nate qendrimi, me numrin e neteve te qendrimit ne hotel. Detyrimi per taksen i takon klientit qe strehoet ne hotel e cila perfshihet ne cmimin e fjetjes dhe mbi te dhe vlera e takses.

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses se fjetjes ne hotel eshte Sektori i te Ardhurave.

IV. TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTES SE PRONESISE PER PASURITE E PALUAJTSHME

Baza e takses mbi kalimin e se drejtes se pronesise per ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit,pronesia e te ciles transferohet. Baza e takses per kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e tjera te paluajtshme eshte vlera e shitjes se tyre.

Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset ne castin e kalimit te se drejtes se pronesise mbi to.

Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme

Nr	Kategorite e ndertesave	Niveli i Takses	
		<i>Nj.Bilisht</i>	<i>Nj.e Tjera</i>

	Ndertesa banimi	100 lek/m ²	100 lek/m ²
	Ndertesa te tjera per tregeti dhe sherbime	300 lek/m ²	300 lek/m ²
	Ndertesa te tjera	200 lek/m ²	200 lek/m ²

Te ardhura te parashikuara nga taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesisë


Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera/ne mije lek	70	71	72	73

Taksa paguhet nga personi qe kalon te drejten e pronesisë mbi pasurine e paluajtshme para kryerjes se regjistrimit ne perputhje me aktet ligjore te Republikës se Shqipërisë.

Menyra e mbledhjes: Agjenti tatimor per vjeljen e takses mbi kalimin e te drejtes se pronesisë mbi pasurine e paluajtshme eshte Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, e cila ne rolin e agjentit tatimor perfiton 3% te shumes se arketuar dhe diferencen e derdh per llogari te buxhetit te Bashkise Devoll jo me vonë se data 30 e muajit pasardhes.

Strukturat pergjegjese per vjeljen e takses: Ngarkohet Sektori i te Ardhurave prane Bashkise per te bere rakordimet e te ardhurave nga kjo takse.

Duke bere nje analize te tabelës se mesiperme shohim se kemi parashikuar nje vlere mesatare per te tre kategorite e ndertesave pasi nuk kemi nje rakordim te sakte te mbledhjes se te ardhurave nga kjo takse. Referim per planifikim eshte bere mbi faktin e nje viti me pare te mbledhjes se te ardhurave nga kjo takse.



V.TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

Baza e takses eshte vlere ne leke e investimit te ri qe kerkohet te kryhet. Klasifikimi si ndertim i ri percaktohet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per dhenien e lejes se ndertimit.

Niveli i takses se ndikimit ne infrastructure sipas kategorive per klasifikimin e investimeve eshte ne tabelen meposhte.

Taksa e ndikimit ne infrastrukture

Nr.	Kategorite e ndertimeve dhe investimeve	Niveli i Takses	
		Nj. Bilisht	Nj. e Tjera
1.	Ndertime per qellime banimi apo njesi sherbimi nga shoqerite e ndertimit, te cilat nuk destinohen per perdorim ne sektorin e turizmit,	6 % te cmimit te shitjes per m ²	4% te cmimit te shitjes per m ²

	industries apo per perdorim publik		
2.	Ndertime te ndryshme nga ato te percaktuara ne piken 1	2% te vleres se investimit	2% te vleres se investimit
3.	Per projektet e infrastructures, per ndertimin e rrugeve, tuneleve, digave, ndertimit te infrastrukturen ne energji, perfshire makinerite dhe pajisjet per keto projekte.	0.1% por jo me pak se kostoja e reabilitimit te infr. se demtuar kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventiv	0.1% por jo me pak se kostoja e reabilitimit te infr. se demtuar kur kjo kosto nuk eshte perfshire ne preventiv
4.	Ndertimet e reja te cilat jane ne process legalizimi	0.5%te vleres se investimit	0.5%te vleres se investimit

Te ardhura te parashikuara per taksen e ndikimit te infrastruktures

Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera/ne mije lek	5000	5050	5100	5150

Baza e taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit. Detyrimi për taksën i takon investitorit. Në rastet kur investitori është Bashkia kjo taksë nuk aplikohet.

Struktura pergjegjese per vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar dhe pergjegjese për llogaritjen dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja është Sektori i studimit, e cila përcjell informacion në Sektorin e Ardhurave. Te gjitha subjektet ndertuese do të terheqin lejen e ndertimit pranë Bashkisë Devoll vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

VI. TAKSA VJETORE E REGJISTRIMIT TE MJETEVE TE PERDORURA

Baza e taksës në këtë rast është lloji i mjetit i cili i nënshtrohet këtij detyrimi. Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njësisë të qeverisjes vendore.


Taksa e regjistrimit te pervitshem te mjeteve te perdorura

Nr	Emertimi i Taksës	Niveli i Taksës	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Taksa e regjistrimit te pervitshem te mjeteve te perdorura	18% * (ardhura-5%)	18% * (ardhura-5%)

Te ardhura te parashikuara nga taksa e mjeteve te perdorura:

Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera/ne mije lek	4000	4040	4080	4120

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses: Struktura e mbledhjes se kesaj takse eshte Drejtoria Rajonale e Sherbimeve te Transportit Rrugor Korce,para kryerjes se kontrollit teknik vjetor te detyrueshem te mjetit.Bazuar ne numrin e mjeteve te regjistruara sipas njesive te qeverisjes vendore dhe te ardhurave te gjeneruara nga kjo takse tetembedhete perqind (18%) te te ardhurave vjetore nga kjo takse i kalon perkatesisht Bashkise Devoll,pasi (DRSHTRR) te kete mbajtur 5% si agjent tatimor.



VII. TAKSA E ZENIES SE HAPESIRAVE PUBLIKE

Baza e taksës për zënien e hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj.

Kategorite e tregëtimit në hapësirat publike që ve në dispozicion Bashkia Devoll dhe niveli i taksës paraqitet në tabelën mëposhte.

Taksa e zenies se hapësirave publike

Nr.	Kategorite e tregetimit	Niveli i Takses	
		Nj.Bilisht	Nj.e Tjera
1.	Tregeti fruta-perime	50 lek/m ²	30 lek/m ²
2.	Tregeti mish dhe peshk	50 lek/m ²	30 lek/m ²
3.	Tregeti industrial	50 lek/m ²	30 lek/m ²
4.	Tavolina te nxjera ne hapësira publike (jo pedonale)/reklamim malli te subjekteve ne hapësira publike	50 lek/tav/ dite lek/m ² /dite	0
5	Tavolina te nxjera ne hapësira publike (pedonale)/	100 lek/tavoline/ dite	0

Struktura pergjegjese per vjeljen e takses: Struktura qe ben vjeljen e kesaj takse eshte Sektori i te Ardhurave ne Bashkine e Devollit, nepermjet inspektorit te tregut ben llogaritjen e detyrimit sipas baze se takses se zenies se hapësirave publike dhe ben derdhjen e saj per llogari te bashkise.

Te ardhura te parashikuara per taksen e zenies e hapësirave publike:

Viti	2018	2019	2020	2021
Vlera /ne mije lek	428	432	436	440

VIII. TAKSA REKLAMES DHE TABELES

Baza e takses: Taksa e tabelës aplikohet per te gjitha subjektet qe duhet te vendosin emertimin e subjektit ne pamjen ballore por jo vetem te njesise ku zhvillojne veprimtarine,ne hapësira te tjera publike te lejuara ose private,qofshin keto te levizshme ose jo dhe qe sherbejne per qellime indetifikimi.

